



Pranuar / Dorezuar Prilbena / Predato Received / Delivered	05.02	2021	1	viti god year
Organ / Niveli Organ / Jedinstvo Org / Unit	No. Prilb Prilb. No.	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPM/SHK	522/2021		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.17/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti - anëtar, si dhe Hysni Mustafa- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.17/2021 të datës 19.01.2021 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë Rruga “Rrahim Gërbeshi”, Lagjja Kalabria, Nr.17, në Komunën e Prishtinës, kundër organit të punësimit Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 05.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.17/2021 e datës 19.01.2021, e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. ANULOHET Vendimi me numër Nr.151/1/20 i datës 23.12.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

III. MBETET në fuqi Vendimi me numër Nr.139/1/20 i datës 11.11.2020, i Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

A r s y e t i m

Me Vendimin me Nr.139/1/20 të datës 11.11.2020 të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ankuesit [redacted] Zyrtar i Lartë Ligjor në kuadër të Departamentit Ligjor në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i ka përfunduar marrëdhënia e punës nga data 01.12.2020, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Ankuesit [redacted] me këtë vendim i është njohur e drejta e pagesës së një page të njëhershme në vlerën e pagës së fundit e cila ankuesit i është kompensuar në muajin dhjetor 2020.

Ankuesi më datë 23.11.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit, duke u bazuar në nenin 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me datë 23.12.2020 ka nxjerr Vendim Nr.151/1/2020 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi kundër Vendimit Nr.151/1/2020 të datës 23.12.2020 të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare më datë 19.01.2021 ka parashtruar ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.01.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ndërsa më datë 01.02.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Autoritetit Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 205/2021 të datës 19.01.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e KZKA-së, Nr.151/1/2020 i datës 23.11.2020; kërkesa për përgjigje e datës 21.01.2021; Përgjigja në kërkesë e datës 01.02.2021; Akt emërimi i ankuesit i datës 08.02.2013; Vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës i datës 11.11.2020; Ankesa drejtuar KZKA-së e datës 23.11.2020; Vendimi i KZKA-së i datës 23.12.2020; Formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 01.12.2020.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit [redacted] është e pabazuar, sepse:

Ankuesi [redacted] me rastin e pensionimit përveç pagesës në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit të paguar nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ka kërkuar edhe kompensimin e tri (3) pagave të tjera përcjellëse me rastin e pensionimit ashtu siç parashihet me Marrëveshje të Përgjithshme Kolektive.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pagat, shtesat në pagë dhe kompensimet e pagës për nëpunësit civilë, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe të akteve nënligjore përkatëse për zbatimin e këtij ligji, me të cilat përveç tjerash në mënyrë decitive përcaktohet edhe kompensimi i nëpunësve civilë me rastin e arritjes së moshës së pensionimit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar që me dispozitat e nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë është përcaktuar që nëpunësit civilë, përveç tjerash kanë të drejtat në vijim:.... „2.2. pagesën për shkak të pensionimit”

Po ashtu me dispozitat e nenit 19 paragrafit 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civilë, është përcaktuar që: „Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit”.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të provave të ofruara nga organi i punësimit, gjegjësisht listës së pagave të muajit dhjetor, konstaton që ankuesit [redacted] i është bërë kompensimi në shumën bruto prej 955.34 Euro si pagesë në shumën e një page mujore në vlerën e pagës së fundit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke marr parasysh faktet e lartcekura konstatoi që ankuesit

_____ i është bërë kompensimi me rastin e pensionimit, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, dhe për këtë arsye vendosi të refuzoj ankesën si të pabazuar, pasi që kërkesa për pagesën e tri pagave me rastin e pensionimit është e bazuar në Kontratën Kolektive, e cila ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 ndërsa sipas nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, është përcaktuar që: **“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”**, prandaj mbi bazë të kësaj mund të konstatojmë që kjo marrëveshje ka qenë në fuqi deri më datë 01.01.2018, dhe si rrjedhojë kjo marrëveshje nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike dhe se e njëjta nuk është nënshkruar më nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, në rastin konkret pasi që ka analizuar dëshmitë e ofruara gjegjësisht Vendimin me numër Nr.139/1/20 të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të datës 11.11.2020 me te cilin ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës me rastin e pensionimit, ka konstatuar se rrjedhimisht ankuesit nuk mund të bëhet kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit sipas Marrëveshjes Kolektive të Kosovës, dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, meqenëse konstaton që Marrëveshja Kolektive e Kosovës nuk është në fuqi, atëherë kompensimi me rastin e pensionimit të nëpunësve civil duhet të bëhet në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë. Andaj në rastin konkret Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave duke u bazuar në dëshmitë e ofruara, konstaton se Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare ankuesit i ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit në muajin dhjetor 2020, dhe se me rastin e kompensimit të ankuesit ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafin 2 nën paragrafin 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafin 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare me rastin e nxjerrjes së vendimit me numër Nr.151/1/2020 të datës 23.12.2020, nuk ka pasur kompetencë ta shqyrtojë dhe të vendosë lidhur me ankesën e ankuesit sepse bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114, për Zyrtaret Publik, respektivisht nenit 24 paragrafit 3 i cili përcakton se **„Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji. E drejta e ankimit në KPMSHC i njihet edhe çdo kandidati në një procedurë pranimi në Shërbimin Civil. Pas shterimit të drejtës së ankimit në KPMSHC, mund të iniciohet konflikt administrativ në gjykatën kompetente për çështjet administrative”**, me çka nënkuptohet se Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në kuadër të institucioneve janë shuar dhe ankesa duhet të parashtrohet drejtpërdrejt në KPMSHC. Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se vendimi me numër Nr.151/1/2020 i datës 23.12.2020, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare është nxjerr nga organi që nuk ka kompetencë dhe se i njëjti është në kundërshtim me nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: **“Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë”**.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.17/2021**

Hysni Mustafa

[Signature]
Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit,*
- *Kryetarit të Bordit të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare*
- *Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*